



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 29.09.2025
Nr. 5-3637

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesës nr. 5/3637 të datës 25.09.2025 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji “Heimerer”, nxjerr:

V E N D I M

Për rilicencimin e programit të studimeve, Infermieri-BSc të Kolegjit “Heimerer”

1. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji “Heimerer” në Prishtinë, rilicencohet për programin e studimit për periudhën 4 vjeçare 2025-2029 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2029),

1.1. Infermieri BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 250 studentë për vit akademik, duke u bazuar në validimin e riakreditimit të AKA-s sipas vendimin 1382/24 të datës 12.07.2024 si dhe vendimin e plotësim/ndryshimit nr. 1712/24 datë 20.08.2024.

3. Bartësi privat i arsimit të lartë, Kolegjit “Heimerer” në Prishtinë, sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim ose tejkalim të këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka shqyrtuar kërkesën me nr. 5/3637 të datës 25.09.2025 të parashtruar nga BPrAL Kolegji “Heimerer”,

dhe vendimit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim me nr.1382/24 të datës 12.07.2024 si dhe vendimin e plotësim/ndryshimit të vendimit me nr. 1712/24 datë 20.08.2024.

Rilicenca e programit të studimit Infermieri BSc të Kolegjit "Heimerer fillon së zbatuari nga ky vit akademik 2025/2026 dhe zgjat deri në përfundimin të programit të studimit.

Komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nuk ka gjetur bazë ligjore që institucionit në fjalë Kolegjit "Heimerer" t'ia njeh retroaktiv programin e studimeve "Infermieri" BSc të akredituar nga AKA për periudhën një vjeçare 2024/25 ku ka punuar pa licencë përkatëse.

Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji "Heimerer" në Prishtinë, nuk rilicencohet për vitin akademik paraparak 2024/2025 për programin e studimit- Infermieri BSc 180 ECTS, sipas vendimin 1382/24 të datës 12.07.2024 si dhe vendimin e plotësim/ndryshimit nr. 1712/24 datë 20.08.2024.

Komisioni për Licencim dhe rilicencim në MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin për aplikim, kërkon nga Kolegji "Heimerer" që brenda vitit kalendarik deri më 01 shtator 2026 të ofroj vendimin për ndryshim të destinacionit nga ai afarist në veprimtari arsimore nga organi kompetent Drejtoria e Urbanizmit -Komuna e Prishtinës.

Nëse brenda vitit kalendarik nuk dorëzohet vendimi i ridestinimit nga organi kompetent - Drejtoria e Urbanizmit, Kolegjit "Heimerer", me Qendrën në Prishtinë, nuk i lejohet regjistrimi i studentëve për vitin akademik 2026/2027.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit "Heimerer";
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

